



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Kaçanikut

Opština Kaçanik

Municipal Kaçanik

01Nr. 60/01-30918 /25
Kaçanik, 18.12.2025

Në bazë të nenit 41 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale të Komunave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28 e datës 04 Qershor 2008), të Udhëzimit Administrativ 2009/01 – të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal-Për Procedurat e Zgjedhjes dhe Përgjegjësitë e Kryesuesit të Kuvendit, të nenit 35 të Statutit të Komunës, Kuvendi i Komunës Kaçanik në mbledhjen e vet të mbajtur më 18 Dhjetor 2025, mori këtë:

V E N D I M
PËR ZGJEDHJEN E KRYESUESIT TË KUVENDIT
TË KOMUNËS KAÇANIK

1. Me këtë Vendim, **SELAJDIN TRONI** nga f. Kovaçec i Komunës së Kaçanikut, me profesion Mr.Sc. i Emergjencave, anëtar i zgjedhur në Kuvendit të Komunës Kaçanik në legjislaturës e 8, nga Partia Demokratike e Kosovës-PDK, zgjedhet: **KRYESUES I KUVENDIT TË KOMUNËS KAÇANIK.**

2. Mandati i Kryesuesit të Kuvendit të Komunës zgjatë aq sa zgjatë mandati i Kuvendit të Komunës, ndërkaq fillon nga dita e zgjedhjes, me 18.12.2025.

3. Detyrat e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës janë të përcaktuara në Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale, Statutin e Komunës dhe në Rregulloren për Punë të Kuvendit të Komunës dhe aktet tjera nënligjore.

4. Për punën e vet, Kryesuesit të Kuvendit të Komunës i takon kompensimi mujor sipas Udhëzimeve Administrative të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

5. Ky Vendim hyn në fuqi 30 ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të MAPL respektivisht 7 ditë pas publikimit në Faqen zyrtare të komunës.

Me këtë Vendim njoftohen: Kryesuesi i Kuvendit, MAPL, Kryetari i Komunës, Udhëheqësi i Personelit, Drejtorja për Buxhet dhe Financa, Arkivi.

Kryesuesi i mbledhjes
Xhelal Dema

